



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës

Univerziteti i Kosovës - Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Nr. _____
Me 14.04.2015
Prishtinë

RREGULLORE

për

udhëtime zyrtare dhe

pjesëmarrje në komisione

Aprovuar me 14.04.2015

Prishtinë

Në bazë të Nenit 98 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, Neni 96 pika 1 të Ligjit të Shëndetësisë së Kosovës Neni 20 pika 6 të Statutit të SHSKUK-së Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së më datën 14.04.2015 miraton këtë:

RREGULLORE PËR UDHËTIME ZYRTARE DHE PUNËN E KOMISIONEVE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Udhëtimet zyrtare nënkuptohen ato lëvizje të cilat kanë një destinacion apo qëllim i cili shërben për kryerjen e detyrave zyrtare në interes të institucionit.

Zyrtarët e institucionit mund të kenë udhëtime zyrtare për nevojat e institucioneve si pjesëmarrës:

1. anëtar i delegacionit,
2. në konferenca,
3. në seminare,
4. në veprimtari të ndryshme për shëndetësi,
5. në bisedime për marrëveshje,
6. për të përcjellë të arriturat në shëndetësi dhe në administratë në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve shëndetësore në sektorin publik.
7. Kryen shërbime shëndetësore jashtë institucionit për nevoja të një institucioni tjetër shëndetësor brenda dhe jashtë vendit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është të rregullojë kompenzimin për udhëtimet zyrtare, meditet dhe pagesat për pjesëmarrje nëpër komisione të ndryshme, për të siguruar një përdorim ekonomik dhe efikas të mjeteve financiare.

Neni 3

Procedurat për realizimin e udhëtimeve zyrtare dhe pjesëmarrja nëpër komisione

Kërkesa për udhëtime zyrtare duhet të dorëzohet brenda **pesë (5) ditë** pune para shkuarjes në udhëtim zyrtar, përveq rasteve të jashtëzakonshme për të cilën vendos Drejtori i Përgjithshëm për Drejtorët e institucioneve vartëse, ndërsa për zyrtarët e institucionit Drejtori ekzekutiv i institucionit përkatës.

Për çdo kërkesë për udhëtim zyrtar duhet zbatuar këto procedura:

1. Çdo punëtor është i obliguar që të parashtojë kërkesë për udhëtim zyrtar, të cilës duhet t'i bashkangjitet arsyetimi me shkrim i aprovuar nga udhëheqësi i drejtëpërdrejtë si dhe ftesa zyrtare e institucionit që ka bërë ftesën.
2. Kërkesa i dorëzohet zyrës së personelit-arhivës për Zyrtarin kryesor administrativ për miratim.

3. Kërkesa duhet të përmbajë shumën e mjeteve financiare të cilat duhet të arsyetohen dhe më pastaj të sillen dëshmitë e duhura për shpenzimet e mjeteve financiare.
4. Nëse miratohet kërkesa për udhëtime zyrtare nxirret vendim dhe i njëjti dorëzohet në Shërbimin për buxhet dhe financa për ekzekutim.
5. Për çdo punëtor që caktohet për punë nëpër komisione përcaktohet pagesa për pjesëmarrje në komision.

Neni 4

Kërkesa për kompenzim për meditje s'bashku me të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare nga personi dhe anëtarët e komisionit të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të përcaktuara sipas **Nenit 1** të kësaj rregulloreje i dorëzohet Shërbimit për buxhet dhe financa brenda afatit **pesëmbëdhjetë (15)** ditësh pune nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar apo pjesëmarrjes nëpër komisione. Në rast të mospërfilljes së këtij afati, kërkesa e tillë do të refuzohet.

Neni 5.

Vlera e meditjeve dhe pjesëmarrjes nëpër komisione

1. Meditjet për udhëtim zyrtar brenda vendit është **20.00 €**.
2. Meditjet për udhëtim zyrtar jashtë vendit është **42.00 €**, duke u bazuar në tarifat për meditje të udhëtimit zyrtar jashtë vendit të Ministrisë së Financave dhe U.A. MSHP.2004/07 për Udhëtimet zyrtare.
3. Kompenzim për pjesëmarrje në hartimin e akteve të brendshme për nevoja të institucionit është **35.00€**.
4. Kompenzimi për ekspert të jashtëm është **30,00 €** për çdo pjesëmarrje maksimum 5 (pesë) herë.
5. ***Kompenzimi për pjesëmarrje nëpër komisione me mandat është 5,00 € për çdo rast, për anëtarë të komisionit, derisa për kryesuesin 10,00 €. –Komisionet e rregullta, me pune brenda orarit të rregullt të punës do duhej kompenzuar me përqindje në page psh 5% në muaj dhe për kryetar 7.5%. Ndersa komisionet që leshojnë qertifikata kompenzimi do të duhej të ishte në nivel 20% të shumës së vlerës që inkaohet nga qertifikata e ndare barabarsisht.***
6. Në rast të shfrytëzimit të automjetit jo zyrtar, kompenzimi bëhet në vlerë prej 0.16 cent për km.

Neni 6

Të gjitha shpenzimet gjatë udhëtimeve zyrtare: shpenzimet e fjetjes dhe ushqimit, të transportit dhe shpenzimet tjera në ngarkim të institucionit shëndetësor i cili ka deleguar punëtorin-stafin e tij për udhëtim zyrtar, për të gjitha rastet mbulohen sipas dokumentit përkatës (faturës, biletës, etj.).

Neni 7

Nëse konstatohen keqpërdorime të mjeteve financiare duhet të informohet Zyrtari kryesor administrativ i institucionit nga personi përgjegjës i financave, ndaj të cilit do të ndërmerren masa përkatëse ligjore kundër personit i cili ka keqpërdorur mjetet.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi me aprovim të drejtorit të përgjithshëm të SHSKUK-së i cili zbatohet nga të gjitha Njësitë përbërëse të SHSKUK-së.

